



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:228164
Datë: 12.02.2024
Numri i dokumentit: 05356353

C.nr.3462/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni civil, gjyqtarja Njomëza Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale D.A. në çështjen juridike kontestimore të propozuesit A.P. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.Sh. nga Prizreni, kundër kundërshtarëve të sigurimit: D.P. nga Prizreni, dhe K.P. nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. E.Gj. nga Prizreni, me objekt kontesti pengim posedimi – me propozim për caktimin e masës së sigurisë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, me datë 12.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si i pa bazuar** propozimi i propozuesit A.P. nga Prizreni, për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën ka kërkuar që të *“1. APROVOHET masa e sigurisë për ngastrat kadastrale me nr. P-71813068-.... në vendin e quajtur “Bregu i Kuq” me kulturë Tokë Bujqësore Arë e Klasës së 3-të, me sipërfaqe të përgjithshme prej 511 m2 në ZK Prizren, të evidentuar sipas certifikatës së pronësisë të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren. 2. T’i ndalohet kundërshtarëve të sigurimit në çfarëdo forme tjetër të tjetërsimit të kësaj paluajtshmërie të përmendur më lartë ndalimin e gropimit të mëtejshëm dhe vendosjen e trafostacionit elektrik me elementet përcjellëse dhe dëmtimit të pronës së mëtejshme të cikët prona shfrytëzohen nga propozuesit e sigurimit, deri në zgjidhjen e kësaj çështje kontestimore ndërmjet propozuesit të sigurimit dhe kundërshtarit të sigurimit. 3. Urdhërohen kundërshtarët e sigurimit me banim në Prizren që në afat prej 3 (tre) ditëve, të ndërpresë të gjitha punimet e vendosjes së trafostacionit shtyllës elektrike me elementet e tjera përcjellëse të tensionit të lartë, duke kthyer gropimin në gjendjen e mëparshme dhe duke ia tërhequr vërejtjen që në të ardhmen kundërshtarët e sigurimit të respektojnë procedurat ligjore të aplikueshme në institucionet e Republikës së Kosovës, që propozuesit të mos e pengojë në këtë mënyrë (formë) apo në forma të ngjashme, deri në zgjidhjen përfundimtare nga gjykata për pengim posedimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.”*
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesi A.P. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av. A.Sh. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 26.10.2023 ka parashtruar propozim për caktimin e masës së sigurisë kundër kundërshtarëve të sigurimit D.P. dhe K.P. që të dy nga Prizreni.

Në propozim i autorizuari i propozueses ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, divizioni Civil, që ta pranojë me urgjencë propozimin e masës së sigurisë në lidhje me pengim posedimin e pronës së propozuesve që kërkohet masa e sigurimit. Kundërshtarët e sigurimit në kundërshtim me të gjitha kriteret e ndërtimit dhe pa asnjë leje përkatëse të organeve kompetente përkatësisht Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor apo nga Korporata Energjetike e Kosovës ku me datë 23.10.2023 ka filluar gropimin për vendosjen e trafostacionit elektrik me të gjitha pajisjet e saj në kufi të ngastrës sime me të cilët nuk ka respektuar distancën e largësisë kundërshtarët e sigurimit, me të cilët pengohet ose i pamundësohet pronarit legjitim të ngastrës kadastrale P-71813068-..... ZK Prizren. Kundërshtarët e sigurimit përveç shfrytëzimit në këtë ngastër kadastrale, kanë bërë edhe dëmtimin e murit rrethues të një pjese të propozuesit të masës, të cilët propozuesit iu është shkaktuar dëm i pariparueshëm me pengimin dhe rrezikimin e anëtarëve të familjes së propozuesit. Për vendosjen e trafostacionit minimumi i largësisë është 6 metra ndërsa në këtë rast nuk e plotëson asnjë kriter të ndërtimit ngase njëherit duhet të pajiset me leje të ndërtimit të objektit dhe më pastaj pasi të pajiset me leje ndërtimi patjetër duhet të kërkohet edhe për vendosjen e trafos. Bazuar në të lartcekurat propozuesve i pamundësohet shfrytëzimi i pronës për shkak të pengim posedimit si dhe ekziston rreziku që të ndryshohet gjendja ekzistuese materiale, duke ndikuar negativisht në realizimin e të drejtave të propozuesit të sigurimit. Bazuar në të lartcekurat dhe theksimet e tjera si në propozim, i ka propozuar gjykatës aprovimin e masës së sigurisë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

E autorizuar e kundërshtares së sigurimit në përgjigje në kërkesë për aprovimin e masës së sigurisë ka theksuar se propozimin e propozuesit e kontestojnë në tërësi si të pa bazuar, i njëjti me këtë propozim dëshiron të pengojë kundërshtarët e sigurimit të kryejnë punimet e tyre pa kurrfarë baze juridike. Kundërshtarët e sigurimit para se të fillojnë punimet rreth ndërtimit të objektit " Afarist dhe banesor" , me etazhitet B+P+6 ne ZK Prizren, ne kuadër të parcelave 5445-7 dhe 5445-8 ZK Prizren, janë pajisur me tërë dokumentacionin përkatës nga të gjitha organet kompetente, duke filluar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastruktues, me të cilin konfirmim, të datës.20.04.2022, me Vendimin e Kuvendit të Komunës te Prizenit Nr.001/011-48192 datë 31.mars 2022 është bërë miratimi i hartës zonale të Komunës së Prizenit për periudhën 2022-2030. Duke ia bashkangjitur të gjitha dokumentet përkatëse prej të gjitha organeve kompetente. Sa i përket pretendimit të propozuesit kinse kundërshtarët e sigurimit po tentojnë të vendosin Trafostacionin Elektrik nuk është e vërtetë se gropimi është bërë për vendosjen e Trafostacionit Elektrik, por gropimi është bërë për të vendosur shtyllat elektrike për me pranë telat e përquesit në vendin e tyre, të njëjti i janë përmbajtur në tërësi kushteve të parapara të pëlqimit të KEDS-it edhe zgjidhjet teknike, mirëpo propozuesi në mënyrë të kundërligjshme i ka larguar shiritat të cilat i kanë vendosur kundërshtarët e propozuesit sipas pëlqimit të KEDS-it, për çka nga ana e policisë dhe inspektoriatit të ndërtimit është paragatur Kallxim Penal ndaj propozuesit. Andaj duke marrë parasysh theksimet e lartcekura si dhe provat e bashkangjitura propozimi i propozuesit nuk i plotësin kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit sipas nenit 297 par.1 a) dhe b) të LPK-së, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzojë propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë.

I autorizuari i propozuesit gjatë mbajtjes së seancave dëgjimore lidhur me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë ka deklaruar se mbetet në tërësi si në propozim për caktimin e masës së sigurimit për ngastrën kadastrale ZK Prizren, duke shtuar se kundërshtarët e sigurimit nuk i kanë respektuar dhe nuk i kanë ndërprerë punimet e tyre edhe përkundër kërkesave të propozuesit të sigurimit ku ende kanë vazhduar me punimet në terren pa ndonjë vendim të organeve administrative dhe pa ndonjë vendim të organeve gjyqësore, dhe në këtë rast propozuesit e sigurimit duke i dëmtuar pronën në mënyrë të dhunshme, përveç gropimeve propozuesit e sigurimit i kanë shkaktuar një pjesë dëm edhe murit rrethues ku i njëjti

e ka rinovuar me financat e tij, dhe nga mosbindja e kundërshtarit të sigurimit nuk janë ndalur punimet e tyre edhe pse janë paralajmëruar nga propozuesit dhe banorët e lagjes. Prona e kundërshtarit të sigurimit nuk i plotësojnë minimumin e kriterëve të ndërtimit dhe të njëjtit kanë hapësirë më pak se 10 ari dhe është në kundërshtim me hartën zonale dhe për këtë arsye propozuesi kërkon nga gjykata që të aprovohet masa e sigurimit për shkak të tjetërsimit dhe dëmtimit të mëtejshëm nga kundërshtarët e sigurimit, po ashtu përgjigja e palës kundërshtare është e pa argumentuar dhe e pa provuar me dokumentacion të institucioneve kompetente e kërkoj nga gjykata që të refuzohet përgjigja nga kundërshtarët e sigurimit të pabazuar në ligj.

E autorizuar e kundërshtarëve të sigurimit gjatë mbajtjes së seancave dëgjimore lidhur me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë ka deklaruar se mbetet në tërësi si në përgjigjen përkitazi me propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, duke shtuar se në rastin konkret nuk qëndrojnë pretendimet e palës propozuese se kundërshtarët e sigurimit nuk posedojnë asnjë dokument. Sa i përket pretendimit të propozuesit kinse kundërshtarët e sigurimit po tentojnë të vendosin trafostacionin elektrik, nuk është e vërtetë përkundrazi gropimi është bërë për vendosjen e shtyllave elektrike për me pranë telat e përcuesit në vendin e tyre, të njëjtit janë përmbytur në tërësi kushteve dhe kriterëve të parapara me pëlqimin e KEDS të cilën e kemi bashkangjitur provave, mirëpo propozuesi në mënyrë të kundërligjshme i ka larguar shiritat të cilat kanë vendosur kundërshtarët e sigurimit, sipas pëlqimit të KEDS-it, për çka ana e policisë dhe inspektoriatit të ndërtimit është paraqitur kallëzim penal ndaj propozuesit. Ka shtuar se nëse gjykata vendos për caktimin e masës së sigurimit, propozojë që propozuesi të jep garancion në kuptim të nenit 297 pika 3 të LPK-së, ngase deri më tani pala kundërshtare ka pasur mjaft dëme, disa herë i janë ndërprerë punimet. Andaj bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të refuzojë propozimin e propozuesit për masën e sigurimit.

Në procedurën e provave të kësaj procedure siguruese, gjykuese ka bërë administrimin e provave dhe atë: leximi i provave i bashkangjitur propozimin për masën e sigurimit dhe atë certifikata pronësisë në ngastrën kadastrale me nr. 05445-6 ZK Prizren, kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me nr. LRP.nr. 5758/2023 REF nr. 1368/2023, dëftesë pagesa, kërkesa e propozuesit drejtuar drejtorisë së inspeksionit në Komunën e Prizrenit, peticioni drejtuar drejtorisë së urbanizmit në Komunën e Prizrenit, përgjigja në ankesë e drejtorisë për urbanizëm dhe planifikim hapësinor me nr. 04-353/01-80574 e datës 10.07.2023 si dhe fotografitë, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, me nr. C.nr. 1237/15 i datës 22.12.20216, procesverbal i drejtorisë së inspektorateve i datës 26.10.2023. Leximi i provave të bashkangjitur përgjigjes lidhur me propozimin për masën e sigurimit dhe atë: vendim i Kuvendit të Komunës me nr. 001/011-48192 të datës 30.03.2022, konfirmimi i vlerësimit të ligjshmërisë me nr. të protokollit 1996-2/2022 të datës 20.04.2022, aktvendimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikimit Hapësinor me nr. 04-351/02-85775 të datës 24.08.2023, njoftimi për plotësim të dokumentacionit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikimit Hapësinor me nr. 04-353/01-45833 të datës 01.06.2023, zgjidhje teknike e lëshuar nga KEDS, me datë 19.10.2023, paramasa për zgjidhje teknike, zgjidhje teknike i datës 13.04.2023, dhënie të kushteve teknike të datës 17.07.2023, nga Hidroregjioni jugor, pëlqim parimor nga VALA e datës 27.06.2023, kopja e planit për ngastrat kadastrale me nr. 05445-7 dhe 05445-8, vërtetimi i mbeturinave të datës 26.06.2023, pëlqim nga Agjencia e menagjimit emergjent e datës 05.07.2023, pëlqim i drejtorisë së shërbimeve publike i datës 17.07.2023, vendim i drejtorisë së shërbimeve publike me nr. 05-352-99104 e datës 25.07.2023 si dhe fotografitë nga vendi i ngjarjes. Leximi i ekspertizës i gjeodezisë punuar nga eksperti i gjeodet O.D. e datës 12.01.2024 dhe dëgjimi i ekspertit në seancën e datës 12.02.2024, leximi i ekspertizës së elektro energjetikës të hartuar nga eksperti Y.Z. e datës 05.02.2024 dhe dëgjimi i ekspertit në seancën e datës 12.02.2024.

Nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë O.D. gjykata ka vërtetuar se propozuesi është bashkëpronar i ngastrës kadastrale me numër 5445-6 ZK Prizren, kjo ngastër në terren shfrytëzohet si shtëpi banimi me oborr dhe garazh. Nga fotografitë bashkangjitur ekspertizës dhe me kqyrje në vend gjykata ka vërtetuar se shtëpia dhe oborri i propozuesit është i rrethuar. Në anën tjetër në terren është vërtetuar se jashtë rrethojave të shtëpisë së propozuesit, kundërshtarët e sigurimit i shfrytëzojnë si tokë ndërtimore ngastrat kadastrale 5446-7 dhe 5446-8 ZK Prizren. Në ngastrat kadastrale në shfrytëzim të kundërshtarëve të sigurimit janë duke u ndërmarrë punime lidhur me vendosjen e shtyllave elektrike.

Nga ekspertiza e ekspertit të elektro-energjetikës Z.Z. gjykata ka vërtetuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me vendosje të tensionit të lartë nga ana e kundërshtarëve të sigurimit. Kundërshtarët e propozimit, në bazë të kërkesave dhe zgjidhjeve të ofruara nga KEDS kanë pasur si qëllim vendosjen e dy shtyllave kapriata metalike, të cilat dy shtylla do të shërbenin për zhvendosjen e linjës 35 kv, të tensionit të mesëm nga linjë ajrore në linjë nëntokësore duke liruar hapësirën mbi parcelat e tyre. Kjo gjë edhe është bërë në teren, si e tillë kjo linjë përkatësisht zhvendosje është tension i njëjtë me linjën paraekzistuese që është bartur përmes shtyllave të betonit. Këta dy shtylla metalike janë të vendosura në drejtim të trasesë paraekzistuese në parcelën e kundërshtarëve të sigurimit dhe ky segment është në mes dy shtyllave ekzistuese të betonit. Vendosja e shtyllave paraqet rrezik në diametër prej 11 metra nga mesi i shtyllës. Vlen të theksohet se tërë zona është e ngarkuar me ndërtime në zonën e sigurisë së linjës. Zgjidhjen teknike që ka ofruar KEDS është zgjidhje parciale e cila nuk ndihmon shumë për të ardhmen e asaj zone. Në këto kushte praktikisht është zgjidhje e vetme. Gjykata ka vërtetuar se në rastin konkret vetëm është bërë ndërrimi i mekanizmave për bartjen e energjisë elektrike nga shtylla të betonit me kablllo në ajër dhe sistem me përcjellje nëntokësore. Vendosja e sistemit nëntokësor e zvogëluar rrezikun në njërin anë por vendosja e kapriatave metalike në afërsi të vendbanimit e kanë shtuar rrezikun për rreth.

Pas analizimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës gjykata erdhi në përfundim se propozimi i propozueses për caktimin e masës së sigurimit në këtë fazë të procedurës **është i pabazuar**.

Me nenin 297 të LPK-së, në mënyrë decisive ceket se *“Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*. Po ashtu me nenin 300 të LPK-së është paraparë se për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit.

Në nenin 304.3 të LPK-së, ku është përcaktuar se mes tjerash, *“propozuesi në propozimin e tij duhet t'i tregoj edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe propozohen mjete provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”*, si dhe që këto *“mjete provuese t'ia bashkëngjisë propozimit”*.

Kështu, gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat propozuesi ia kanë bashkangjitur propozimit, vlerësimin e ekspertizës së gjeodezisë dhe asaj të elektroenergjetikës të nxjerra në këtë çështje kontestuese, gjykata ka konstatuar se propozimi i palës propozuese për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit në këtë fazë të procedurës është i pabazuar.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe propozimit të propozuesit, erdhi në përfundim se propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit është i pabazuar për shkak se propozuesi nuk ka ofruar prova të mjaftueshme materiale që do të bënin të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive të paraparë në nenin 297.1 pika a) të LPK-së, si dhe nuk ka ofruar prova të mjaftueshme të cilat do të vërtetonin edhe kushtin tjetër të paraparë me nenin 297.1 pika b) të LPK-së, e që është ekzistimi i rrezikut real se pa caktimin e masës së propozuar pala propozuese do ta kishte të pamundur realizimin e kërkesës (për pengim posedim, marrë parasysh që paditësi veçse ka paraqitur padi për pengim posedim), e këto dy kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Gjykata ka ardh në përfundim se caktimi i masës në këtë fazë është i paarsyeshëm, për faktin se kërkesëpadia që është propozuar të sigurohet është për pengim posedim, e në këtë fazë të procedurës për gjykatën nuk është e besueshme e drejta subjektive. Gjykata me rastin e shqyrtimit të padisë do të shqyrtoj provat e nevojshme nga ku do të dal në përfundim lidhur me të drejtën subjektive të këtu propozuesit A.P. Në procedurën siguroese gjykata ka tagër vetëm të vlerësoj provat lidhur me arsyeshmërinë e caktimit të masës së sigurimit, e që në rastin konkret nga provat e bashkangjitura dhe të nxjerra në këtë procedurë nuk është bërë e besueshme e drejta subjektive.

Duke pasur parasysh ato që u thanë më sipër, gjykata konkludon se nga pretendimet e ngritura në propozim, si dhe nga provat e ofruara nga ana e propozuesit të masës së sigurimit gjykata të njëjtin propozim e ka refuzuar ngase nuk ka ofruar prova se plotësohet kushti i parë ligjor për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, ai i të drejtës subjektive, e rrjedhimisht nuk është plotësuar as kushti i dytë, i paraparë në nenin 297 pika b) të LPK-së që konsiston në rrezikun se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës ose në shkaktimin e dëmit të konsiderueshëm.

Arsye tjetër që ka dërguar në refuzimin e kësaj mase ka qenë edhe fakti se masat e sigurimit nuk guxojnë ta përshijnë kërkesën që sigurohet me anë të tyre, pra duke u nisur nga formulimi i kërkesës në lidhje me caktimin e masës së sigurisë, dhe me shikimin në padinë për pengim posedim gjykata vlerëson se me aprovimin eventual të propozimit dhe caktimin e masës do të përfshihej në masë të madhe kërkesëpadia e paditësit, dhe kjo është në kundërshtim me nenin 300.3 të LPK-së, ku shprehimisht parashihet: “*Masat e sigurimit nga ky nen nuk guxojnë në tërësi ta përfshijnë kërkesën që sigurohet me anë të tyre.*”

Bazuar në të lartcekurat, gjykata e refuzoi propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, pasi vlerësoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297 par. 1 pika b të LPK-së, për t’u caktuar një masë e tillë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, bazuar në nenin 450 të LPK-së, ku secila palë paraprakisht i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta, pasi që për palën propozuese është refuzuar propozimi për caktimin e masës së sigurisë, ndërsa kundërshtarët e sigurimit nuk i kanë kërkuar ato.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitave ligjore të parapara nenin 142 par. 5 të LPK-së, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:228164, 12.02.2024

B. Profesionale
Delvina Ajazaj

Gjyqtarja
Njomëza Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.